



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:260784

Datë: 13.10.2020

Numri i dokumentit: 01185263

P.nr.1032/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit A.M. , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2370/19 të dt.08.11.2019 për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit A.M. dhe të prokurorit të shtetit Sadije Muriqi me dt .13.10.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.M. i lindur me dt....., në Pejë rruga 12Qershori 1999, ku edhe tani jeton , i njohur me dokument identifikues numër, i biri i XH. dhe nënës L. e gjinisë G., ka të kryer shkollën mesme , i pa punë , i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datë ... rreth orës 18:30 , në rrugën “Toni Bler” , në Pejë , pa autorizim ka poseduar narkotike , në atë mënyrë që ditën kritike Njësitit DHTN-së , pas pranimit të informacionit se i pandehuri A.M. i cili është i njohur për këtë njësit , është duke lëvizur në afërsi të Qendrës Zejtare në Pejë ku me vete kishte një çantë të vogël në krah dhe se dyshohet se në të njëjtën ka substancë narkotike , të njëjtit i vihen në përcjellje dhe në momentin kur i pandehuri arrin në qendër të qytet në adresë të lartcekur , pas kontrollimit tek i njëjti në çantën e krahut i është gjetur një qese plasmasi në brendi të së cilës tri qese të vogla plasmasi dhe një paketim i mbështjellë me folie ngjyrë alumini me substancë të dyshuar narkotike e për të cilat i pandehuri pranon se janë të tija dhe i ka për përdorim personal , e cila substancë pas ekzaminimit ka rezultuar se është e llojit marihuanë dhe e njëjta prej 8.8 gram dhe e cila më pas është sekuestruar nga policia.

-me çka ka kryer vepre penale : posedim i paautorizuar i narkotikëve dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 38, 39, 46,47,48,49, dhe nenit 269 par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

E GJYKON :

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , dhe:

Me dënim me burgu,

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale.

Substanca narkotike e llojit “ (Marihuan) ,, në peshë prej 8.8 gr . KONFISKOHET

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.08.11.2019 kundër të pandehurit A.M., ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2370/19, për vepër penale: posedim i paautorizuar i narkotikëve dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë e që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, gjendjen e varfër ekonomike – familja e të pandehurit janë të gjithë të papunësuar, moshën e re, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin substancës narkotike është marrë konform nenit 62 par 2 pika 2.7 dhe nenit 69 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.13.10.2020.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .